



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:086406
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05428878

PAKR.nr.749/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Hashim Çollaku - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Blerina Sallauka, në çështjen penale kundër të akuzuarve F. B dhe J. D, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur në lidhje me ankesat e mbrojtëseve të akuzuarve F. B, av.Meshari Selimaj dhe J. D, av.Shaqir Vula, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:086406 i datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 07.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e mbrojtëseve të akuzuarve F. B, av.Meshari Selimaj dhe J. D, av. Shaqir Vula, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për të Krime të Rënda, 2023:086406 i datës 30.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për të Krime të Rënda me aktgjykimin 2023:086406 të datës 30.11.2023, të akuzuarit F. B dhe J. D, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së i ka shpallur fajtor dhe i ka gjykuar si në vijim; Në pikën I të dispozitivit të akuzuari F. B për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej dymijë euro (2,000 €) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 43 të KPRK-së, nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet euro (20 €) me një (1) ditë burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 06.04.2023 e tutje, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ndërsa në pikën II të dispozitivit të akuzuarin J. D për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej njëmijë euro (1,000 €) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (2) vitesh, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 43 të KPRK-së, nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej pesëdhjetë (50) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet euro (20 €) me një (1) ditë burgim.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 06.04.2023 e tutje, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Të akuzuarve i'u janë konfiskuar dhjetë (10) qese najloni të mbushura me substancë të dyshuar narkotike, me peshë prej 5.686 kg.

Të akuzuarit F. Bashkëshkurti mjetet monetare Para 500 (1x50 €, me nr. serik ...; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik ...; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik)

serik; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, me nr. serik; 1x50 €, nr. serik); Para 1,800 Lekë (10000 Lekë me nr. serik; (1x2000 Lekë, me nr. serik ...; 10000 Lekë, me nr. serik ...; 1x2000 Lekë me nr. serik ...; 10000 Lekë me nr. serik ...; 1x2000 Lekë, me nr. serik ...; 10000 Lekë, me nr. serik ...; 1x2000 Lekë, me nr. serik ... dhe 10000 Lekë, me nr. serik ..., një (1) telefon iPhone dhe një (1) veturë Mercedes Benz, ngjyrë hiri, me targat e Republikës së Shqipërisë ..., me numër të shasisë: ..., pronë e të akuzuarit F. B.

Të akuzuarit J. D i është konfiskuar një (1) telefon Poco.

Është urdhëruar Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e substancës narkotike të përshkruar si më lartë.

Është urdhëruar Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të shesë, likujdoj ose të mbajë pasurinë e luajtshme të cekur më lartë.

Janë obliguar të akuzuarit e lartcekur, që secili veç e veç të i paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor secili të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit secili të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50.00 €), të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit F. B, av.Meshari Selimaj, për shkak të vendimit mbi lartësinë e dënimit, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën e tij dhe ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:086406 i datës 30.11.2023, në kuptim të pretendimeve të ankesës ashtu që të akuzuarit F. B të i shqiptojë dënim më të butë me burgim dhe me gjobë, i cili do të ishte adekuat, që i përgjigjet personalitet të akuzuarit dhe me të cilin do të arrihej qëllimi i ndëshkimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. D, av.Shaqir Vula, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimi të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, konfiskimin e dobisë pasurore, kërkesës pasurore- juridike dhe vendimit për publikimin e aktgjykimit, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës të anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:086406 i datës 30.11.2023 dhe çështja të i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për

rivendosje ose të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, ashtu që i akuzuari J. D për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, të lirohet në tërësi nga aktakuza.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.4/2024 e datës 05.01.2024 ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F. B, av. Meshari Selimaj dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit J. D, av. Shaqir Vula, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, 2023:086406 i datës 30.11.2023, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën kanë marrë pjesë i akuzuari F. B dhe mbrojtësi tij, av. Meshari Selimaj, i akuzuari J. D dhe mbrojtësi i tij J. D, av. Shaqir Vula, ndërsa Prokurori i Apelit nuk ka prezantuar në seancë, ndonëse i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt. Mbrojtësi i të akuzuarit F. B, av. Meshari Selimaj në seancën e kolegjit ka qëndruar pran pretendimeve ankimore të ushtruara në ankesë dhe ka shtuar se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën e cila i vihet barrë. Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrur një vendim të padrejtës sa i përket lartësisë së dënimit. Si rrethanë rënduese ka konsideruar faktin se i pandehuri ka qenë më parë i dënuar në Shqipëri. I akuzuari F. B deklaroi se e mbështet në tërësi avokatin e tij. Mbrojtësi i të akuzuarit J. D, av. Shaqir Vula ka qëndruar pran pretendimeve ankimore të ushtruara në ankesë dhe nuk ka çfarë të shtoj më tepër përveç se mbete pranë propozimit në ankesë. I akuzuari J. D deklaroi se e mbështet në tërësi avokatin e tij.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F. B, av. Meshari Selimaj dhe mbrojtësit të akuzuarit J. D, av. Shaqir Vula, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F. B, av. Meshari Selimaj

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë thekson se i akuzuari që në seancën e shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer dhe ka shprehur pendesë të madhe. Mbrojtja pretendon se i akuzuari këtë gabim të madh e ka bërë nga kushtet e rënda ekonomike dhe varfëria.

Po ashtu, mbrojtja i citon rrethanat rënduese të cilat i ka gjetur Gjykata e shkallës së parë, duke vënë theks të veçantë tek fakti se i akuzuari ka deklaruar vet në mënyrë të sinqertë se ka qenë

më përpara i dënuar për vepra penale të natyrës së tillë. Kjo sepse mbrojtja pretendon që Gjykata lidhur me këtë rrethanë rënduese nuk e ka marrur fare parasysh kohën e kryerjes së veprës penale në Shqipëri dhe rehabilitimin ligjor të akuzuarit për atë vepër, mirëpo vetëm në mënyrë abstrakte është thirrur në këtë rrethanë.

Mbrojtja gjithashtu citon edhe rrethanat lehtësuese të cilat i ka marrur parasysh Gjykata e shkallës së parë, mirëpo konsideron se Gjykata të njëjtat nuk i ka vlerësuar sa duhet. Sipas mbrojtjes, Gjykata nuk ka zbatuar nenin 69 par.3 pika 3.6 dhe 3.7 të KPRK-së, ndonëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje për kryerjen e veprës penale dhe premtimit se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla.

Për më tepër, mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar zbutjen e dënimit sipas nenit 71 par.1 pika 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, përkundër faktit që janë plotësuar kushtet për aplikimin e kësaj dispozite. Kështu, sipas mbrojtjes me shqiptimin e dënimeve ndaj të akuzuarve si në dispozitivin e aktgjykimi të atakuar, Gjykata ka vepruar po thuaj se njëjtë për të dy të akuzuarit dhe nuk i ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese për të akuzuarin F, vetëm se i përshkruar ato.

Rrjedhimisht, mbrojtja pretendon se dënimi i shqiptuar referuar nenit 38 të KPRK-së nuk është në përputhje me qëllimin e tij dhe në rastin konkret nuk do të ketë efektin e duhur risocializues, nuk është në pajtim me përgjegjësinë penale të kryesit dhe sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës, e sidomos në krahasim me qëndrimin e të mbrojturit të tij me të akuzuarin tjetër.

Gjithashtu, mbrojtja pretendon se shqiptimi i një dënimi kaq të lartë me burgim dhe me gjobë, është në kundërshtim edhe me praktikën e vendosjes së këtij lloji të çështjeve penale nga e njëjta Gjykatë. Mbrojtja këtë argument lidhur me dënimin me burgim e mbështet me aktgjykimin PAKR.nr. 378/20 të dt. 28.12.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ndërsa pretendimin lidhur me dënimin me gjobë e mbështet me aktgjykimin PKR.nr. 2023:017143 të dt. 12.04.2023 të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Mbrojtja konsideron se Gjykata ka mundur të i shqiptoj të akuzuarit një dënim më të ulët, për shkak se i akuzuari ka e ka përjetuar rëndë këtë vepër, po vuan shpirtërisht, nuk e ndien veten aspak mirë, nuk është përsëritës i veprave penale, është 34 vjeçar, i pa martuar, nuk ka krijuar familje dhe dënimin e shqiptuar në këtë lartësi goditet edhe familja e tij, përkatësisht nëna invalide dhe babai të cilët tërë mbështetjen fizike dhe materiale e kanë nga djali i tyre.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit J. D, av. Shaqir Vula

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë *shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale* referuar nenit 384 të KPPRK-së, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye të nevojshme dhe të mjaftueshme lidhur lartësinë e dënimit të shqiptuar, provat dhe arsyetimin e mbrojtjes lidhur me pafajësinë e të akuzuarit, si dhe është i bazuar në prova të papranueshme.

Po ashtu, mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe *shkelje të ligjit penal*, sepse në rastin konkret ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, pasi që për kryerjen e kësaj vepre penale është i nevojshëm paramendimi dhe dashja.

Gjithashtu, lidhur me *vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike*, mbrojtja pretendon se në procedurën e zhvilluar para Gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar bindshëm se i akuzuari J. D nuk ka qenë në bashkëveprim me të akuzuarin F. B për veprën e cila i vihet barrë të akuzuarit J. D. Po ashtu, mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar nuk ka argumentuar me asnjë prove të besuar përshkrimin që Prokuroria ia bën ngjarjes dhe prandaj konsideron se Gjykata është mbështetur në një paragjykim apo fikSION, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim ndaj të akuzuarit J. dhe vendimit për vazhdimin e masës së paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Për më tepër, mbrojtja pretendon se me asnjë nga provat e ekzaminuara nuk ka rezultuar se i akuzuari J. është i përfshirë dhe ka dorë në këtë çështje. Madje, shton se është konstatuar edhe në aktgjykimin e ankimuar nga ekzaminimi i gjurmëve të vijave papilare nuk është gjetur asnjë gjurmë në qeset dhe çantat e mbushura me narkotik. Po ashtu, thekson se i akuzuari F. me deklarimin e tij ka vërtetuar se me rastin e kalimit kufitar të akuzuarit J. nuk i janë kontrolluar dokumentet e udhëtimit, mirëpo nuk është kontrolluar as automjeti e as bagazhi i të akuzuarit F. Sipas mbrojtjes, Gjykata ka abstrahuar mundësinë që sasia e narkotikëve të ketë qenë në veturë me rastin e kalimit të pikës kufitare.

Gjithashtu, mbrojtja pretendon se me aktgjykimin e ankimuar është bërë vetëm përshkrimi i elementeve të veprës penale e cila i vihet barrë të akuzuarit sipas nenit 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, mirëpo nuk është bërë ndarja e secilit element dhe analizimi i tyre, pasi që po të ishte bërë do të rezultonte se asnjë nga elementet e kësaj vepre penale nuk e tangojnë të akuzuarin Jetnor.

Ndërkaq, mbrojtja pretendon se Gjykata nuk ka aplikuar drejtë ligjin penal me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, për shkak se i akuzuari J. nuk ka një të kaluar

kriminale as në Kosovë dhe as në Shqipëri ku jeton, nuk është akuzuar apo dënuar për ndonjë veprë penale, është njeri që i përkushtohet familjes dhe punës e jo kriminalitetit. Andaj, mbrojtja konsideron se vendimi i drejtë në këtë çështje është lirimi i të akuzuarit J. nga aktakuza.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Vlerësimi i pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit J. D, lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë dhe as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit gjen se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtjes, se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu i njëjti është në përputhshmëri të plotë me arsyetimin. Gjithashtu, përpilimi i dispozitivit është bërë konform dispozitave të nenit 369 par. 4 e lidhur me nenin 365 të KPPK-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 267 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke vepruar kështu konform dispozitave të nenit 369 par. 6 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë, vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 të KPP-së, kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga të akuzuarit i cili edhe pse nuk e ka pranuar fajësinë megjithatë nuk e ka mohuar faktin se është takuar me të akuzuarin F por është arsyetuar se nuk e ka ditur se çka ka Fi në makinë, pasi që unë kam pasur të shkoj në muzikë live në Prizren, pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive, dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit J. D, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike

në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për shkak se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Jetnor, në bashkëkryerje ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Jetnor, në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin të aktgjyqimit të ankimuar, e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor : me datën 06.04.2023, rreth orës 20:31/h, në rrugën Ponoshec-Gjakovë, i akuzuari F së bashku me të akuzuarin J. në bashkëkryerje, pa autorizim dhe më qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, transportojnë substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, në atë mënyrë që të njëjtit së bashku më veturën e të akuzuarit F, të tipit Mercedes Benz, ngjyrë hiri, me targat e Republikës së Shqipërisë ..., nga Tropoja janë nisur në drejtim të Kosovës, ku i pandehuri F. ka vozitur veturën dhe ka kaluar në pikën kufitare Qafë Morinë, ndërsa i akuzuari J. kalon pjesën malore të vijës kufitare në këmbë, duke bartur me vete dy çanta me substancë narkotike, pastaj janë takuar së bashku në pjesën e fshatrave të vijës kufitare, dhe janë nisur në drejtim të Gjakovës, ku në hyrje të qytetit në lagjen Brekoc, është ndaluar vetura e të akuzuarve dhe pas kontrollit të veturës nga ana e zyrtareve policor janë gjetur dhjetë (10) qese najloni të mbushura me substance narkotike, të llojit kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme neto prej 5125 ± 0.025 gram.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë kishte ardhur pas administrimit provave në shqyrtimin gjyqësor siç janë: Raporti fillestar i dt.06.04.2023, raporti i policit A. K i dt.06.04.2023, vërtetimet mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt.06.04.2023, raporti i kërkimit të personave i sistemit për menaxhimin e kufirit i dt.07.04.2023, raporti i ekspertimit të substancës narkotike me Nr. AKF/2023-1213/23-1127 i dt.09.06.2023, raporti i ekspertimit të telefonit nga Agjencioni i Forenzikës me nr. AKF/2023-0153 i dt.05.06.2023 me dy CD-ve, raporti i ekspertimit të AKF-së, me nr. AKF/2023-1213/23-1614 I IDT.07.07.2023, i cili ka të bëjë me ekzaminimin e gjurmëve të vijave papilare, si dhe foto dokumentacioni, i cili ndodhet në shkresat e lëndës.

Pretendimi i mbrojtësit se në procedurën e zhvilluar para Gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar bindshëm se i akuzuari J. D nuk ka qenë në bashkëveprim me të akuzuarin F. B për veprën e cila i vihet barrë të akuzuarit J. D. Po ashtu, mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar nuk ka argumentuar me asnjë prove të besuar përshkrimin që Prokuroria ia bën ngjarjes, janë pretendime të pa bazuar pasi që këtë rrethanë gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar përveç nga provat e administruara edhe nga raporti plotësues i datës 05.06.2023, konstatohet se *të pandehurit me njëri-tjetrin kanë komunikuar me datë 06.04.2023,*

katër (4) herë nga ora 19:59 min deri në orën 20:27 min, kohë kjo ku konsiderohet se e ka kaluar kufirin, e që vërtetohet edhe nga Raporti i kërkimit të personave nga Sistemi për Menaxhimin e Kufirit (SMK) i dt.07.04.2023, se me datën 06.04.2023 (dita kritike), në ora 20:26:00, i akuzuari F. B, ka hyrë në Republikën e Kosovës, i vetëm, përmes pikë kalimit kufitar Qafë Morinë, me veturën e markës Mercedes Benz, me targa Përveç kësaj se nëse të akuzuarit e kanë kaluar kufirin bashkë në një automjet, cila ka qenë arsyeja se të njëjtit kanë komunikuar katër herë nga ora 19:59 e deri në orën 20:27, përmes telefonit, duke pasur parasysh deklaratat e tyre se kinse gjatë gjithë kësaj kohe kanë qenë bashkë në të njëjtën veturë.

Po ashtu kolegji trajtoj edhe pretendimet e mbrojtjes lidhur me atë nga provat e ekzaminuara nuk ka rezultuar se i akuzuari J. është i përfshirë në këtë çështje, është konstatuar se nga ekzaminimi i gjurmëve të vijave papilare nuk është gjetur asnjë gjurmë në qeset dhe çantat e mbushura me narkotik, gjithashtu është pretendim i pa bazuara pasi që nga raportit për gjurmët latente i dt.07.07.2023, nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë është dhënë konstatimi se gjurmët e dërguara për ekzaminim nuk kanë karakteristika individuale të mjaftueshme për krahasim dhe nuk kanë dhënë asnjë identifikim, mirëpo në raport me provat e tjera kjo rrethanë nuk e përjashton përgjegjësin e të akuzuarit që i njëjti të ketë qenë pjesëmarrës gjatë kryerjes se kësaj veprë penale.

Po ashtu, mbrojtësi në ankesë thekson se i akuzuari F. me deklarin e tij ka vërtetuar se me rastin e kalimit kufitar të akuzuarit J. nuk i janë kontrolluar dokumentet e udhëtimit, mirëpo nuk është kontrolluar as automjeti e as bagazhi i të akuzuarit F, Gjykata ka abstrahuar mundësinë që sasia e narkotikëve të ketë qenë në veturë me rastin e kalimit të pikës kufitare, për kolegjin ky pretendim nuk është relevant, në këtë rast gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar si jokontestuese faktin se në automjetin me Mercedes Benz, ngjyrë hiri me targa të Shqipërisë, gjatë kontrollit janë gjetur dhjetë (10) qese najloni të mbushura me substancë narkotike, e llojit kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme 5125 ± 0.025 gram, dhe se në momentin e ndalimit dhe kontrollimit të automjetit, në automjet ka qenë edhe i akuzuari J. D.

Ndërsa pretendimi i mbrojtjes se me aktgjykimin e ankimuar është bërë vetëm përshkrimi i elementeve të veprës penale e cila i vihet barrë të akuzuarit sipas nenit 267 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, mirëpo nuk është bërë ndarja e secilit element dhe analizimi i tyre për të akuzuarin Jetnor, janë pretendime të pa bazuara, për arsye se nga provat e administruar kanë rezultuar se provuari elementet e veprës penale për të cilin i akuzuari është shpallur fajtor.

Andaj, Gjykata e Apelit e Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lartë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë, e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë, kjo për faktin se veprimet e të akuzuarit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale, për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, se për këtë vepër penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit në këtë drejtim.

Pretendimet e mbrojtëseve të akuzuarve F. B, av. Meshari Selimaj dhe J. D, av. Shaqir Vula përkitazi me vendimin mbi dënim.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit F për një dënim më të butë dhe mbrojtësit të akuzuarit J. D, av. Shaqir Vula, për ta liruar nga akuza, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat që konform dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Kështu për të akuzuarin F. B si rrethanë renduese ka vlerësuar, se i njëjti ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këto vepra penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, rrezikshmërinë -vlerën e mbrojtur shoqërore, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri dhe sasia/lloji i narkotikut të konfiskuar në këtë çështje penale, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale e cila cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë dhe nga deklarimi i të akuzuarit rezulton se i njëjti ka qenë i dënuar më parë në Republikën e Shqipërisë, për vepër penale që lidhet me substanca narkotike. Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë, faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë qysh në fazën fillestare të procedurës penale, rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është i papunë, janë katër anëtarë të familjes, si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, pasi që i akuzuari ka pasur sjelle korrekte si me organet e ndjekjes ashtu edhe me gjykatën gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Për të akuzuarin J. D, si rrethana rendues ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këto vepra penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, ndërsa si rrethana renduese ka vlerësuar, rrezikshmërinë vlerën e mbrojtur

shoqërore, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri dhe sasia/lloji i narkotikut të konfiskuar në këtë çështje penale, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale (rrezikshmërinë e lartë të veprimeve inkriminuese të këtyre të akuzuarve), ku kjo rrezikshmëri e lartë kriminale, cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale. Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari jeton së bashku me prindërit e tij, ka punuar si shofer, bazuar në shkresat e lëndës i akuzuari para këtij rasti nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, i njëjti ka pasur sjellje korrekte si me organet e ndjekjes ashtu edhe me gjykatën gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit F. B, av. Meshari Selimaj që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë me burgim dhe me gjobë, janë pretendime të pa bazuara që nuk justifikojnë zbutjen e dënimit kur merret parasysh puna e veprës penale - sasia e narkotikut, kurse pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit J. D, av. Shaqir Vula që në mungesë të veprës penale i akuzuari të lirohet nga dënimi, në vlerësim e fakteve të vërtetuar është pretendim i pa argumentuar, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e Gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për të Mitur

PAKR.nr.749/23, datë 07.02.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Blerina Sallauka

Anëtarët e kolegjit
Kadrije Goga Lubishtani

Kryetar i kolegjit
Xhevdet Abazi

Hashim Çollaku
